



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KP.nr.10/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gent Bekeri, në çështjen juridike të paditësit “V...”, me pronar V.P, me seli në Gjakovë, kundër të paditurit “J...” me seli në Vranje, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit E.Z, me objekt kontesti vërtetim pronësie, me datën 01.02.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit “V...”, me pronar V.P, me seli në Gjakovë, e ushtruar më datën 26.12.2008, kundër të paditurit “J...” me seli në Vranje, për vërtetim pronësie.

A r s y e t i m

Paditësi “V...”, me pronar V.P, me seli në Gjakovë, më datën 26.12.2008, ka parashtruar padi kundër të paditurit “J...” me seli në Vranje, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë.

Në shqyrtimin përgatitor të datës 01.02.2023, nuk ka prezantuar paditësi, për të cilin Gjykata ka dëshmi se i njëjti ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën për në seancë nuk e ka arsyetuar, i autorizuari i të paditurit ka propozuar që konform dispozitave të LPK-së padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr.

Meqenëse paditësi nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit përgatitor, mungesën e tij nuk e ka arsyetuar edhe pse i njëjti ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, fakt ky i vërtetuar nga fletëkthesa e datës 16.01.2023, dhe sipas propozimit të autorizuarit të paditurit, gjykata vendosi që të njëjtën ta konsideroj të tërhequr në kuptim të nenit 409 par.1 të LPK-së

Nga të lartcekurat Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 409 par.1 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhomat e Shkallës së Parë,

Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.10/22 me datë 01.02.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.